



Duke u bazuar në rekomandimet e komisionit të studimeve dhe në qëndrimet e Senatit të Universitetit, në mbledhjen e XIII të datës 24.11.2014, Rektori i universitetit aprovon këto:

MASA DISIPLINORE SHITESË

Për mbarëvajtjen sa më të mirë të provimeve, kollokviumeve dhe testeve

I

Me masa disiplinore shtesë nënkuptojmë shqiptimin e masave disiplinore ndaj studentëve të cilët i thyejnë rregullat dhe dispozitat statutare që kanë të bëjnë me organizimin dhe mbarëvajtjen e provimeve apo kollokviumeve, ligjëratave dhe ushtrimeve dhe që nuk janë të parapara me Rregulloren për masat dhe procedurën disiplinore për personelin mësimor dhe studentët.

II

Studentët janë të obliguar t'u përmbahen obligimeve ligjore që dalin nga aktet e përgjithshme të universitetit, gjatë kohës së hyrjes në provim dhe në kohën e mbajtjes së ligjëratave dhe ushtrimeve. Për cenimin e detyrimeve dhe rregullave ligjore të universitetit studentët do të përgjigjet për shkelje disiplinore. Shkelje disiplinore e studentit konsiderohet çdo tentim apo veprim i tij, të cilin e përdor për të kopjuar apo falsifikuar, për të marrë dhe për të dhënë informata të paautorizuara nga studentët e tjerë, me qëllim të plotësimit të testit apo kollokviumit në mënyrë të kundërligjshme.

III

Përgjegjës për organizimin, mbarëvajtjen dhe përmbylljen e secilit provim (kollokvium, test) është bartësi i lëndës dhe asistenti i cili e ndihmon atë.

IV

Gjatë mbajtjes së provimeve (kollokviumeve, testeve) studentëve:

- U ndalohet rreptësisht të kenë me vete çanta të çfarëdo lloji, duke i përfshirë edhe ato të femrave;
- U ndalohet rreptësisht të marrin me vete libra, fletore, letërza apo çfarëdo material tjetër të karakterit kopjues;
- U ndalohet rreptësisht të kenë me vete telefona ose pajisje të ngjashme elektronike. Këto pajisje nuk lejohen edhe nëse janë të fikura. Pajisjet që gjinden te studentët do të konfiskohen dhe do të dorëzohen te komisioni disiplinor, i cili do t'i mbajë për aq kohë sa zgjat edhe masa e ndëshkimit;
- U ndalohet rreptësisht të bëjnë ndërrimin e testeve mes tyre;
- Studentët obligohen të kontrollojnë bankën e tyre në tërësi, nëse ka ndonjë material (letër), apo është shënuar diçka, menjëherë ta njoftojnë përgjegjësin e sallës në mënyrë që të hiqet ai material apo përshkrim;

V

Të gjithë ata studentë të cilët identifikohen se i kanë thyer rregullat nën paragrafin IV, herën e parë do t'i shqiptohet masa disiplinore: **ndalim në paraqitje dhe hyrje në provime për 1 vit (tre afate të rregullta), kurse herën e dytë përjashtim nga universiteti (neni 17 pika 3 dhe 5 të Rregullores për masat disiplinore për personelin akademik dhe studentët).**

VI

Nëse përgjegjësi i provimit nuk i përmbahet këtyre masave, atëherë edhe ndaj tij do të shqiptohet masa nga komisioni disiplinor.

VII

Këto masa hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tyre dhe njëkohësisht do të publikohen në ueb faqe të universitetit.

05.12.2014, Gjilan



UD REKTORI

/ Prof.Ass.Dr. Arben Dërmaku /